



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 126, datë 17.05.2021

MBI

MIRATIMIN E REGULLORES PËR INTEGRITETIN DHE TRANSPARENCËN E
TREGUT ME SHUMICË TË ENERGJISË (REMIT)

Në mbështetje të nenit 16, 19, 20, gërmat “ç” dhe “d”, nenit 22, 51, pika 2, gërma “dh” dhe 97, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 4, gërmat “a”, “b”, “c” “ç”, dhe pikat 5 dhe 6, të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 28, pika 1, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 17.05.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 68/5prot., datë 07.05.2021 dhe Informacionin Shtesë nr. 68/5 – (1), datë 14.04.2021, të Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 256, datë 21.12.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, nëpërmjet shkresës nr. 1325 prot., datë 31.12.2020, drafti i rregullores REMIT është përcjellë për opinione dhe komente në: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare, Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Foreign Investors Association of Albania (FIAA), Albanian Renewable Energy Association (AREA), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Palëve të sipërcituara u është kërkuar të japin opinionet dhe komentet përkatëse, mbi draftin e rregullores REMIT brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nëpërmjet shkresës së 12 Janarit 2021, (REG-AL/O/jko/01/12-01-2021) mirëpriti mundësinë e ofruar për të kontribuar në konsultimin publik të hapur nga ERE, në vijim të vendimit nr. 256, datë 21.12.2020 si dhe ofroi disa sugjerime lidhur me përmbajtjen e draft Rregullores, si në vijim:
 - Në nenin 1, pika 1, fjalia e parë duhet të zëvendësohet nga fjalia: “Kjo rregullore transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë”.

Lidhur me këtë koment të parë të Sekretariatit, vlerësohet se sugjerimi i dhënë lidhur me këtë pikë, do të përcaktojë më qartë se Rregullorja e cila është draftuar nga ana e ERE me qëllim harmonizimin e kuadrit rregullator (si një nga përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 19 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar) për zhvillimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror ka si qëllim të transpozojë Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

- *Në nenin 2, pika 1.15, termi “elektrike” në fund të paragrafit duhet të hiqet. Rregullorja REMIT i referohet njëkohësisht energjisë elektrike dhe gazit dhe duhet të bëhet relevante në lidhje me TAP. Përkufizimi i “sektorit të energjisë”, në pikën 1.9, saktësisht nuk është i kufizuar vetëm në tregun e energjisë elektrike.*

Lidhur me këtë koment të Sekretariatit, bëhet me dije se, si dhe përcaktuar në pikën 1, të nenit 1, draft Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë, përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në tregjet me shumicë të energjisë, përfshirë energjinë elektrike dhe gazin natyror. Në këtë draft Rregullore, përkatësisht në nenin 2, pikat 1.15 dhe 1.18, janë përkufizuar respektivisht si Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, ashtu edhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror sipas fushave të tyre të posaçme të veprimtimit qoftë në fushën e energjisë elektrike, qoftë në atë të gazit natyror. Për këtë arsye gjykohet që termi “elektrike” të mbetet i pandryshuar në këtë pikë, e cila korrespondon me përkufizimin e dhënë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

- Në vijim, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, evidenton gjithashtu se, sa i përket niveleve të penaliteteve të referuara në nenin 16 (Masat administrative dhe Gjohat) është vërejtur se referimi tek penalitetet e parashikuara në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar nuk plotësojnë kërkesat e nenit 18, të Rregullores REMIT për penalitete efektive, dekurajuese/frenuese dhe proporcionale, të cilat janë në gjendje të reflektojnë në mënyrë fleksibile kohëzgjatjen dhe seriozitetin e shkeljes dhe dëmet e shkaktuara klientëve dhe tregtimit. Kjo në thelb bie ndesh me vetë fushëveprimin e Rregullores REMIT, sigurimin e integritetit të tregut me shumicë. Megjithatë, siç dhe Sekretariati shprehet, rritja e mëtejshme e niveleve të ndëshkimit, nga ana e ERE-s duhet të kërkojë ndryshime legjislative.
- AAES, nëpërmjet shkresës nr. 1 prot., të datës 29.02.2021, me lëndë “Komente lidhur me miratimin e Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, ka shprehur konsideratën e saj pozitive për fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë, si dhe ka propozuar si më poshtë vijon:
 - *Nenin 1.21 (Pozitë Dominuese) propozohet që të mos përfshihet në Rregullore, pasi nuk përputhet me Rregulloren e BE si dhe Vendimin e EnCS, si dhe nuk është në përputhje të plotë me nenin 3.5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*

Lidhur me këtë sugjerim të AAES, sqarojmë se, draft Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë, në nenin 2, pika 1.21, jep përkufizimin e pozitës dominuese si “pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e

tjerë në treg si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët". Nëse do i referohemi pikës 5, të nenit 3, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", përcaktohet se me pozitë dominuese do të kuptojmë atë "fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët" është e qartë që pika 1.21, e Rregullores ka përshtatur në mënyrë korrekte dhe është në përputhje me përkufizimin e dhënë nga ky Ligj.

Gjithashtu, si dhe referuar vetë qëllimit të Rregullores e cila përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në tregjet me shumicë të energjisë, sqarojmë se përkufizimi lidhur me pozitën dominuese është i domosdoshëm pikërisht për shkak se ajo shfaqet si një nga format e abuzimit që mund të përdoret nga shoqëritë dhe grupimet e shoqërive, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg, me qëllim cenimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

- Në lidhje me nenin 1.21 (referuar përmbajtjes së shpjegimit të dhënë në shkresën nr. 1 prot., të datës 29.02.2021, me lëndë "Komente lidhur me miratimin e Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)", kuptohet që ndonëse shoqata referon nenin 1.21, ka parasysh nenin 15 (E drejta e ankesës) të draft Rregullores) AAES shprehet se, në draft Rregullore është përcaktuar që kundër vendimit të ERE-s, më të cilin konstatohet shkelja e Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë nuk është e lejuar ankesa. AAES propozon që ky nen të mos përfshihet në Rregullore pasi kufizon thelbësisht të drejtat e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

Lidhur me këtë propozim të AAES, sqarojmë se ndryshimet e reflektuara në këtë nen njohin njëkohësisht të drejtën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE në bazë të legjislacionit në fuqi si dhe të drejtën e ankimit ndaj këtyre të fundit, si dhe përcaktuar përkatësisht në nenin 16, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) përcolli në ERE përmes shkresës me nr. 47/1 prot., datë 15.02.2021, komentet e saj në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë. Komentet e OST sh.a., për lehtësi shqyrtimi mund të ndahen në dy grupe: në komente të natyrës gjuhësore dhe përmbajtjesore. Komentet e natyrës përmbajtjesore janë si vijon:
 - Në **nenin 2**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që: *Pika 1.3 (i) të bëhet 1.3.1. hyrja në ndonjë transaksion ose bërja e një porosie për tregtimin e produkteve me shumicë të energjisë, i cili...*

Lidhur me këtë pikë të draft Rregullores, sqarojmë se duke iu referuar nenit 2, germa (a), të Rregullores REMIT Nr.1227/2011, gjykohet se mbetja e pandryshuar e togefjalëshit "lëshimi i ndonjë urdhri", në këtë dispozitë, është në përputhje të plotë me sa parashikuar në dokumentin REMIT Nr.1227/2011. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh që Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë i referohet njëkohësisht blerjes dhe shitjes së produkteve të energjisë me shumicë zëvendësimi i termit "lëshimi i ndonjë urdhri" me termin "bërja e një porosie" do të nënkuptonte aplikimin e

këtij termi, vetëm tek blerja e produkteve, pasi termi porosi lidhet më shumë me procesin e blerjes në tërësi, ndërkohë që termi “lëshimi i ndonjë urdhri” si dhe parashikuar në këtë dispozitë, i referohet njëkohësisht blerjes dhe shitjes së produkteve të energjisë me shumicë.

- Në **nenin 2**, të draft Rregullores, OST sh.a, propozon që: Pika 1.6 “Produkte të energjisë me shumicë - nënkupton kontratat dhe dokumentet që janë derivat i tyre, pavarësisht se ku dhe si tregtohen...”

OST sh.a propozon të rishikohet përkthimi i termit “Produkte të energjisë me shumicë” sipas Rregullores REMIT Nr. 1227/2011, duke sqaruar me qartë përkufizimin për derivativët. Lidhur më këtë propozim të OST sh.a. sqarojmë se pika 1.6, e nenit 2, të draft Rregullores është në përputhje të plotë me pikën (4), të nenit 2, të Rregullores REMIT Nr. 1227/2011 në të cilën jepet përkufizimi i “wholesale energy products”.

Lidhur me derivativët, Rregullorja REMIT Nr. 1227/2011, në germën (b), të pikës (4), të nenit 2, shprehet mbi derivatet në lidhje me energjinë elektrike ose gazin natyror të prodhuar, tregtuar ose shpërndarë brenda Bashkimit (Evropian), ndërsa në germën (d) shprehet mbi derivatet në lidhje me transportin e energjisë elektrike ose gazit natyror brenda Bashkimit Evropian.

- Në **nenin 2**, të draft Rregullores, OST sh.a, propozon që: *Në pikën 1.11 “Pjesëmarrës i tregut”, togfjalëshi “vendosjen e urdhrave për tregti” të ndryshohet në “bërjen e porosive”.*

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., si dhe evidentuar në ndryshimet e propozuar më sipër, përkatësisht në pikën 1.3 (i), sqarojmë se mbetja e pandryshuar e togfjalëshit “lëshimi i ndonjë urdhri”, në këtë dispozitë është në përputhje të plotë me sa parashikuar në dokumentin REMIT Nr.1227/2011.

- Në **nenin 2**, të draft Rregullores, OST sh.a, propozon që: *Në pikën 1.15, “Operator i Sistemit të Transmetimit”, të hiqet togfjalëshi “person fizik” në përkufizimin e dhënë në draft Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë.*

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., shprehemi se, si dhe përcaktuar në pikën 48, të nenit 3, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe pikën 66, të nenit 4, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, “Operator i Sistemit të Transmetimit” ose “OST” është person **juridik**.

- Në lidhje me përkufizimet e bëra në pikën **1.16 dhe 1.17, të nenit 2**, për “Ndërmarrje” dhe “Ndërmarrje e lidhur”, OST sh.a. propozon që në përputhje me Rregulloren REMIT Nr. 1227/2011, përshtatur me Vendim të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë të muajit Janar 2018, termat e përdorur në nenin 2, pikat 12 dhe 13, janë:

(12) parent undertaking

(13) related undertaking.

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., vlerësohet se të dy termat e propozuar, “shoqëri mëmë” dhe “shoqëri e kontrolluar” janë në përputhje me termat juridikë të përdorur në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- Në **nenin 3**, të draft Rregullores, OST sh.a, propozon që, pika 4.1, të bëhet: *“Transaksionet e kryera për shlyerjen e detyrimit që është bërë i kërkueshëm, për të blerë ose shitur me shumicë produkte të energjisë, ku detyrimi ka lindur si*

rrjedhoje e lidhjes së një marrëveshje apo bërjes së një porosie, përpara se personi në fjalë/i përmendur të ketë marrë informacionin e brendshëm”.

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., bëjmë me dije se pika 4.1, e këtij neni është ri përshtatur plotësisht sipas përmbajtjes së Rregullores REMIT 1227/2011, për këtë arsye gjykohet e ezauruar nevoja për ndryshime të mëtejshme të saj.

- Në **nenin 4**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që pika 1, të bëhet: *“Pjesëmarrësit e tregut duhet të publikojnë në mënyrë efektive dhe në kohë informacionin që ata posedojnë në lidhje me biznesin ose shoqëritë të cilat pjesëmarrësi në fjalë i tregut, shoqëria e tij mëmë ose shoqëria e kontrolluar, zotërojnë ose kontrollojnë ose për çështjet e tyre operacionale për të cilat pjesëmarrësi në treg ose shoqëria është përgjegjëse, qoftë tërësisht ose pjesërisht. Ky publikim do të përfshijë informacione të rëndësishme për kapacitetin dhe përdorimin e objekteve për prodhim, magazinim, konsum ose transmetim të energjisë elektrike ose të gazit natyror, ose në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve të GNL-se, duke përfshirë gatishmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve”.*

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., vlerësohet se ai më së shumti ka një karakter gjuhësor (është bërë zëvendësimi i termit ndërmarrje me termat shoqëria mëmë dhe shoqëria e kontrolluar) dhe ka si qëllim të lehtësojë kuptueshmërinë e kësaj dispozite.

- Në **nenin 4**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që, pika 2, të bëhet: *“Një pjesëmarrës tregu, përjashtimisht mund të vonojë nën përgjegjësinë e vet, bërjen publike të informacionit të brendshëm, në mënyrë që të mos paragjykojë interesat e tij të ligjshme, me kusht që një veprim i tillë të mos mashtrtojë publikun dhe me kusht që pjesëmarrësi i tregut të jetë në gjendje të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni dhe të mos marrë vendime në lidhje me tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë bazuar në atë informacion. Në një situatë të tillë, pjesëmarrësi i tregut, pa asnjë vonesë, do të vërë në dispozicion të ERE informacionin së bashku me arsyetimin për vonesën e publikimit të tij”.*

Lidhur me këtë koment të OST sh.a., sqarojmë se ndryshimet e propozuara në pikën 2 të nenit 4, mundësojnë një përshtatje më të plotë të saj me pikën (2) të nenit 4 të Rregullores REMIT Nr. 1227/2011.

- Në **nenin 4**, të draft Rregullores, OST sh.a. ka propozuar që në pikën 3, të bëhet vetëm ndryshimi i togfjalëshit *“statuti i shoqërisë”*.
- Lidhur me **nenin 7**, të draft Rregullores, OST sh.a. ka propozuar përkatësisht në pikën 2, që të bëhet ndryshimi në *“Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut bëhet pa cënuar detyrimet për të qenë në përputhje me rregullat e zbatueshme të tregtimit dhe balancimit”*.

Si dhe parashikuar në paragrafin e tretë, të nenit 9, të Rregullores REMIT nr. 1227/2011, sqarojmë se parashikimi i përcaktuar në pikën 2, të draft Rregullores objekt shqyrtimi, i për afrohet më së shumti parashikimit të Rregullores REMIT nr. 1227/2011, për këtë arsye komenti i OST sh.a., vlerësohet të mos merret parasysht.

- Në **nenin 8**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që në këtë dispozitë përveç Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrotjtjen e të dhënave Personale” të shtohet dhe Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Duke mbajtur parasysh që konfidencialiteti i informacionit të ndjeshëm tregtar nuk është i parashikuar në Ligjin nr. 119/2014 gjykohet se nuk është i nevojshëm përfshirja e tij në këtë dispozitë.

- Në **nenin 11**, të draft Rregullores, OST sh.a. ka propozuar në pikën 4 dhe 5, ndryshimin e termit “akte” me “veprime”.
- Në **nenin 14**, të draft Rregullores, OST sh.a. ka propozuar heqjen e termit “organ politik” nga pika 3, e këtij neni.
- Në **nenin 15**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që: *Pika 1, e kësaj dispozite të bëhet: Kundër Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me te cilën konstatohet shkelja e kësaj Rregulloreje dhe aplikimi i masave ndëshkuese si dhe kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, i licencuari mund të bëjë ankim në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Vendosjes dhe Reduktimit të Gjobave. Kundër vendimit për aplikimin e gjobës, brenda 30 ditësh nga publikimi i vendimit, mund të behet ankim në gjykatën kompetente në Republikën e Shqipërisë.*

Lidhur me këtë propozim të OST sh.a., si dhe bërë me dije më sipër, ndryshimet e reflektuara në këtë nen njohin njëkohësisht të drejtën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe të drejtën e ankimit ndaj këtyre të fundit, si dhe përcaktuar përkatësisht në nenin 16, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

- Në **nenin 16**, të draft Rregullores, OST sh.a. propozon që pika 4, e këtij neni të ndryshohet në: *“Për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, ndaj personit fizik dhe juridik do të aplikohen gjoba nga (500 000 Lekë) deri në kufirin ligjor të përcaktuar në ligjet e përmendura në pikën 3, të këtij neni”*

Propozimi i OST sh.a., në lidhje me këtë pikë, vlerësohet se ndihmon në përcaktimin më qartë të penaliteteve të cilat rrjedhin nga shkeljet e pikës 3, të nenit 16, si dhe në referimin e saktë tek neni 107, i ligjit nr.43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe neni 106, i ligjit nr.102/2015 për Sektorin e Gazit Natyror.

- Sa i përket ndryshimeve në pikën 8, të nenit 16, OST sh.a. propozon që kjo pikë të bëhet *“Gjoha e vendosur nga bordi i ERE përbën titull ekzekutiv, dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile”*.

Sa i përket këtij propozimi, vlerësohet se ndryshim i propozuar bën që kjo pikë e nenit 16, të Rregullores të përafrohet me detyrimet që rrjedhin ndaj të licencuarve sipas pikës 5, të nenit 107, të ligjit nr.43/2015 dhe pikës 6, të nenit 106, të ligjit nr.102/2015.

- Autoriteti i Konkurrencës, përmes shkresës nr. 13/2 prot., të datës 23.04.2021, protokolluar në ERE me nr. 627 prot., datë 27.04.2021 ka bërë me dije se procedura e nisur përmes vendimit të bordit të ERE-s nr. 256, datë 21.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- Me qëllim përafrimit sa më të plotë të parashikimeve të Rregullores me legjislacionin në fuqi për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, nenet 14, 15 dhe 16, të cilat parashikojnë përkatësisht afatet për marrjen e vendimit dhe publikimin e tij, të drejtën e ankesës si dhe masat administrative dhe gjobat janë rishikuar në pjesën më të madhe të tyre.

- Për sa më sipër, ERE vlerëson:
 - Të pranojë sugjerimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për ndryshimin e pikës 1, të nenit 1 e cila bëhet:
 - **Neni 1** (Qëllimi dhe Fushëveprimi), pika 1: Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.
 - Të mos pranojë sugjerimin e kërkesës së Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për ndryshimin e pikës 1.15, të nenit 2, të Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë.
 - Të mos pranojë kërkesën e AAES për mos përfshirjen e pikës 1.21, të nenit 2 dhe nenit 15, të Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë.
 - Të pranojë kërkesën e OST sh.a., për ndryshimin e pikave 1.15, 1.16 dhe 1.17, të nenit 2, pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 4, pikave 4 dhe 5, të nenit 11, pikës 3, të nenit 14, si dhe pikave 4 dhe 8, të nenit 16, të cilat bëhen:
 - **Neni 2, pika 1.15, Operator i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike**- është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
 - **Neni 2, pika 1.16, Shoqëri mëmë** - një shoqëri, e cila në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, si dhe përcaktuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
 - **Neni 2, pika 1.17, Shoqëri e kontrolluar** - shoqëria tjetër e cila vlerësohet si e kontrolluar nga shoqëria mëmë, si dhe përcaktuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
 - **Neni 3, pika 4.1** - Transaksionet e kryera në përmbushjen e një detyrimi që ka ardhur për shkak të blerjes ose shitjes së produkteve të energjisë me shumicë kur ky detyrim vjen si pasojë e një marrëveshjeje të lidhur, ose një urdhri për tregtimin, i vendosur përpara se personi në fjalë të binte në dijeni të informacionit të brendshëm.
 - **Neni 4, pika 1** - Pjesëmarrësit e tregut duhet të publikojnë në mënyrë efektive dhe në kohë informacionin që ata posedojnë në lidhje me biznesin ose shoqëritë të cilat pjesëmarrësi në fjalë i tregut, shoqëria e tij mëmë ose shoqëria e kontrolluar, zotërojnë ose kontrollojnë ose për çështjet e tyre operacionale për të cilat pjesëmarrësi në treg ose shoqëria është përgjegjëse, qoftë tërësisht ose pjesërisht. Ky publikim do të përfshijë informacione të rëndësishme për kapacitetin dhe përdorimin e objekteve për prodhim, magazinim, konsum ose transmetim të energjisë elektrike ose të gazit natyror,

- ose në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve të GNL-se, duke përfshirë gatishmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve.
- **Neni 4, pika 2** - Një pjesëmarrës tregu, përjashtimisht mund të vonoje nën përgjegjësinë e vet, bërjen publike të informacionit të brendshëm, në mënyrë që të mos paragjykojë interesat e tij të ligjshme, me kusht që një veprim i tillë të mos mashtrtojë publikun dhe me kusht që pjesëmarrësi i tregut të jetë në gjendje të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni dhe të mos marrë vendime në lidhje me tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë bazuar në atë informacion. Në një situatë të tillë, pjesëmarrësi i tregut, pa asnjë vonese, do të vërë në dispozicion të ERE informacionin së bashku me arsyetimin për vonesën e publikimit të tij.
 - **Neni 4, pika 3** - Kurdo që një pjesëmarrës tregu ose një person i punësuar ose që vepron në emër të një pjesëmarrësi të tregut, zbulon informacionin në lidhje me një produkt energjie me shumicë gjatë ushtrimit të zakonshëm të profesionit ose detyrave të tij, siç referohet në pikën 2, të Nenit 3 (1), pjesëmarrësi i tregut ose personi duhet të bëjë zbulimin e menjëhershëm, të plotë dhe efektiv të atij informacioni të publiku. Në rast të një zbulimi jo të qëllimshëm, pjesëmarrësi i tregut duhet të sigurojë publikimin e plotë dhe efektiv të informacionit sa më shpejt që të jetë e mundur pas zbulimit jo të qëllimshëm. Ky paragraf nuk do të zbatohet nëse personi që merr informacion ka detyrimin e fshehtësisë, pavarësisht nëse detyrimi i tillë rrjedh nga ligji, rregulloret, statuti i shoqërisë ose ndonjë kontratë.
 - **Neni 11, pika 4** - Kur ERE dyshon se veprimet që kryhen në një Palë Kontraktuese tjetër janë duke ndikuar në tregjet ose çmimet e produkteve të energjisë me shumicë në Shqipëri, atëherë mund të kërkojë nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë të sigurojnë që kërkesat e rregullores REMIT të zbatohen në atë Palë Kontraktuese.
 - **Neni 11, pika 5** - Për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj abuzimit të tregut të energjisë me shumicë, ERE do të informojë Autoritetin e Konkurrencës, Sekretariatit dhe Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, kur ka bazë të arsyeshme për të dyshuar se ka veprime që janë duke u kryer ose janë kryer në tregun e energjisë me shumicë, të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në vend apo tek Palët Kontraktuese.
 - **Neni 14, pika 3** - Të gjitha vendimet merren në mënyrë të pavarur nga cilido organ publik, apo çfarëdo shoqëri publike apo private.
 - Të pranoj pjesërisht, propozimin e OST sh.a., sa i përket ndryshimit të nenit 15 të Rregullores, i cili bëhet:
 - **Neni 15** – 1. Kundër vendimit të ERE-së, me të cilin konstatohet shkelja e kësaj Rregulloreje dhe aplikimit të masave ndëshkuese si dhe kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, pjesëmarrësi i tregut mund të kërkojë rishikimin e këtij vendimi në bazë të legjislacionit në fuqi.
 2. Kundër vendimit për aplikimin e gjobës, brenda afateve të parashikuara ligjore përkatësisht në nenin 16, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nga publikimi i vendimit, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative në Republikën e Shqipërisë.

- **Neni 16, pika 4** - Për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 3, të këtij neni, ndaj personit fizik dhe juridik do të aplikohen gjoba nga (500 000 Lekë) deri në kufirin ligjor të përcaktuar në ligjet e përmendura në pikën 3 të këtij neni.
- **Neni 16, pika 8** - Gjoba e vendosur nga bordi i ERE përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.
 - Të pranojë propozimet e OST sh.a., sa i përket ndryshimeve të karakterit gjuhësor të Rregullores të pikës 4, të nenit 1, pikave 1 dhe 2, të nenit 6, nenit 10, 11 dhe 17.
 - Të mos pranojë propozimet e OST sh.a., sa i përket ndryshimeve të Rregullores në pikat 1.3 (i), 1.6 dhe 1.11, të nenit 2, pikën 2, të nenit 7 dhe nenit 8.
 - **Neni 14, pika 1**- Vendimmarrja për fillimin e një procedure për vendosje gjobe si dhe vendimmarrja për konstatimin dhe vendosjen e gjobës, përfshirë dhe afatet e parashikuara për këto dy vendimmarrje, ERE i merr bazuar në nenin 107, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 106, të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10 279, datë 20.05.2010, “Për Kundërvajtjet Administrative”, Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 125, datë 29.07.2016 dhe Rregulloren mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 04.07.2017.
 - **Neni 14, pika 2**- ERE në raste të veçanta si dhe parashikuar në nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative mund ta zgjasë afatin për marrjen e vendimit me 30 ditë.
 - **Neni 14, pika 4** - ERE boton në Fletoren Zyrtare, si dhe publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e marra.
 - **Neni 15, pika 1** - Kundër vendimit të ERE-së, me të cilin konstatohet shkelja e kësaj Rregulloreje dhe aplikimit të masave ndëshkuese si dhe kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, pjesëmarrësi i tregut mund të kërkojë rishikimin e këtij vendimi në bazë të legjislacionit në fuqi.
 - **Neni 15, pika 2** - Kundër vendimit për aplikimin e gjobës, brenda afateve të parashikuara ligjore përkatësisht në nenin 16, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nga publikimi i vendimit, mund të bëhet ankimi në gjykatën administrative në Republikën e Shqipërisë.
 - **Neni 16, pika 5** - ERE në përputhje me nenin 107, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenin 106, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr.102/2015 për Sektorin e Gazit Natyror, nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, të Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 125, datë 29.07.2016 dhe neneve 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, të Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 04.07.2017, mund të aplikojë gjobë progresive ose ta reduktojë atë rast pas rasti.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Miratimin e “Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë” (REMIT). (Bashkëlidhur me Shtojcën A)
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021

RREGULLORE PËR INTEGRITETIN DHE TRANSPARENCËN E TREGUT TË ENERGJISË ME SHUMICË

Tiranë

Maj 2021

Përmbajtja

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi.....	3
Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimet.....	3
KREU II NDALIMI I TREGTIMIT DHE DETYRIMI PËR PUBLIKIM I TË DHËNAVE...9	
Neni 3 Ndalimi i tregtimit nga personat e brendshëm	9
Neni 4 Detyrimi për të publikuar informacionin e brendshëm	10
Neni 5 Ndalimi i Manipulimit të Tregut	12
KREU III MONITORIMI DHE REGJISTRIMI I PJESËMARRËSE NË TREG	13
Neni 6 Monitorimi i tregut.....	13
Neni 7 Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut.....	13
KREU IV INFORMATAT KONFIDENCIALE	15
Neni 8 Mbrojtja e të dhënave.....	15
Neni 9 Besueshmëria Operacionale	15
Neni 10 Detyrimet e personave që profesionalisht rregullojnë transaksionet	15
Neni 11 Bashkëpunimi në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe në nivel kombëtar	15
Neni 12 Sekret i profesional	17
KREU V MBIKQYRJA, HETIMI DHE MASAT ADMINISTRATIVE	18
Neni 13 Zbatimi i ndalimeve ndaj abuzimit të tregut	18
Neni 14 Afatet për marrjen e vendimit dhe publikimit të tij.....	18
Neni 15 E drejta e ankesës	19
Neni 16 Masat administrative dhe Gjobat	19
KREU VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	22
Neni 17 Ndryshimet.....	22
Neni 18 Interpretimi.....	22
Neni 19 Hyrja në fuqi	22

RREGULLORE PËR INTEGRITETIN DHE TRANSPARENCËN E TREGUT TË ENERGJISË ME SHUMICË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

- 1 Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë transponon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.
2. Rregullorja, po ashtu parashikon monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë nga Enti Rregullator i Energjisë.
3. Rregullorja zbatohet për tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë.
4. Rregullorja nuk cënon aplikimin e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionit kombëtar lidhur me konkurrencën në tregun e energjisë.
5. ERE përfaqësohet si bashkëpunon me , autoritetin e konkurrencës dhe autoritetet e tjera relevante kombëtare, për të siguruar që është marrë një qasje e koordinuar për zbatimin e këtyre rregullave, ku veprimet ndërlidhen për një ose më shumë produkte të energjisë me shumicë, në të cilat zbatohen Nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje.
6. ERE do të bashkëpunojë me organet kompetente gjyqësore, dhe organet e tjera në çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet që ndikojnë në integritetin e tregut me shumicë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Informacion i brendshëm** - do të thotë informacioni i një natyre të saktë që nuk është bërë publik, që lidhet direkt ose indirekt me një ose më shumë produkte të energjisë me shumicë dhe që, nëse do të bëhej publik mund të ndikojë në çmimet e atyre produkteve.
 - 1.2. Për qëllimet e këtij përkufizimi, **informacion** do të thotë:
 - 1.2.1. informacioni që kërkohet të bëhet publik në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e

Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejten e informimit” duke përfshirë aktet nenligjore të miratuara në përputhje me këto ligje;

- 1.2.2. informacioni në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e impianteve për prodhimin, ruajtjen, konsumin ose transmetimin e energjisë elektrike ose të gazit natyror ose lidhur me kapacitetin dhe përdorimin e impianteve të GNL-së (Gaz natyror i lëngshëm), përfshirë mungesën e disponueshmërisë së planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve;
 - 1.2.3. informacioni që kërkohet të zbulohet në përputhje me parashikimet ligjore të rregullores (EC) No 714/2009 dhe (EC) No 715/2009 në Komunitetin e Energjisë ose në nivel kombëtar, rregullat e tregut dhe kontratat ose parimet në tregun përkatës me shumicë, të energjisë përderisa ky informacion ka të ngjarë të ketë një efekt mbi çmimet e produkteve të energjisë me shumicë;
 - 1.2.4. informacione të tjera që një pjesëmarrës tregu do të mund të përdorte si pjesë e bazës së vendimit të tij për të hyrë në një transaksion në lidhje me, ose për të lëshuar një urdhër për të tregtuar një produkt të energjisë me shumicë; dhe
 - 1.2.5. informacioni do të konsiderohet të jetë i një natyre të saktë nëse tregon një sërë rrethanash që ekzistojnë ose mund të pritët të shfaqen në mënyrë të arsyeshme, ose një ngjarje që ka ndodhur ose mund të pritët të ndodh, dhe nëse është mjaft i specifikuar për të mundësuar nxjerrjen e një konkluzioni lidhur me efektin e mundshëm të atyre rrethanave ose ngjarjeve mbi çmimet e produkteve të energjisë me shumicë;
- 1.3. **Manipulimi i tregut** - do të thotë:
- 1.3.1. hyrja në ndonjë transaksion ose lëshimi i ndonjë urdhri për tregtimin e produkteve me shumicë, të energjisë i cili:
 - i. jep ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë; të energjisë
 - ii. siguron ose përpiqet të sigurojë, nga një person ose persona që veprojnë në bashkëpunim, çmimin e një ose disa produkteve me shumicë të energjisë në një nivel artificial, përveç nëse personi i cili ka hyrë në transaksion ose ka lëshuar urdhrin për tregti, ka arsye të ligjshme për ta bërë këtë dhe se ky transaksion ose urdhër për tregti përputhet me praktikën e pranuar të tregut në tregun me shumicë të energjisë në fjalë; ose
 - iii. përdor ose tenton të përdorë një mjet fiktiv ose ndonjë formë tjetër të mashtrimit ose kontradiktues, e cila jep, ose mund të japë sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë ;
 - 1.3.2. ose shpërndarjen e informacionit përmes medias, duke përfshirë internetin ose çfarëdo mjeti tjetër, i cili jep, ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose çorientuese

në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë, duke përfshirë shpërndarjen e lajmeve të rreme ose mashtruese, kur personi që e ka shpërndarë e dinte, ose duhet ta kishte ditur, se informacioni ishte i rremë apo mashtrues.

1.4. Kur informacioni shpërndahet për qëllime gazetareske ose qëllime artistike, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që udhëheqin lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në mediat e tjera, përveç nëse:

1.4.1. personat kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, avantazh ose fitime nga shpërndarja e informacionit në fjalë; ose

1.4.2. zbulimi ose shpërndarja bëhet me qëllim të çrregullimit të tregut në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë ;

1.5. **Përpjekje për të manipuluar tregun** - do të thotë:

1.5.1. hyrja në ndonjë transaksion, duke lëshuar ndonjë urdhër për të tregtuar ose ndërmarrë ndonjë veprim tjetër në lidhje me një produkt me shumicë energjie me qëllimet e mëposhtme:

i. dhënia e sinjaleve false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë;

ii. sigurimin e çmimit të një ose disa produkteve me shumicë të energjisë në një nivel artificial, përveç nëse personi që ka hyrë në transaksion ose ka lëshuar urdhrin për tregti, vërteton se arsyet e tij për ta bërë këtë janë të ligjshme dhe se transaksioni ose urdhri për tregëtim përputhet për praktikën e pranuar të tregut në tregun e energjisë me shumicë në fjalë; ose

iii. përdorimi i një mjeti (mekanizmi) fiktiv ose ndonjë forme tjetër mashtrimi ose mjeti që jep, apo mund të japë, sinjale false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë; të energjisë ose

1.5.2. shpërndarjen e informacionit përmes mediave, duke përfshirë internetin ose çdo mjet tjetër me qëllim dhënien e sinjaleve false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë;

1.6. **Produkte të energjisë me shumicë** - nënkupton kontratat dhe dokumentet që janë derivat i tyre, pavarësisht se ku dhe si tregtohen:

1.6.1. kontratat për furnizimin me energji elektrike ose gaz natyror, kur dërgesa është në Shqipëri;

1.6.2. kontratat që lidhen me transportin e energjisë elektrike ose gazit natyror në Shqipëri.

1.7. **Kontratat për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike ose gazit natyror për shfrytëzim nga konsumatorët fundor** - nuk janë produkte me shumicë të energjisë. Megjithatë, kontratat për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

ose të gazit natyror tek konsumatorët fundor me një kapacitet konsumi më të madh se pragu i përcaktuar në pikën 1.9, do të trajtohen si produkte energjie me shumicë.

- 1.8. **Kapaciteti i konsumit** - nënkupton konsumin e konsumatorit fundor të energjisë elektrike ose të gazit natyror në shfrytëzim të plotë të kapacitetit të atij konsumatori. Ai përfshin të gjithë konsumin nga ai konsumator si një njësi ekonomike e vetme, për aq sa konsumi bëhet në tregjet me çmime të ndërlidhura me shumicë.

Për qëllime të përkufizimit në pikën 1.8 të këtij Neni, konsumi në impiantet individuale nën kontrollin e një njësie ekonomike të vetme që ka një kapacitet konsumi më të vogël se 600 GWh në vit, nuk do të merret parasysh, përderisa këto impiante nuk ushtrojnë ndikim të përbashkët në çmimet e tregut të energjisë me shumicë për shkak të vendosjes së tyre në tregje të ndryshme përkatëse gjeografike;

- 1.9. **Sektori i energjisë** - nënkupton sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në të cilin marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, depozitimit, shpërndarjes, furnizimit si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror rregullohen nga Ligji nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligji nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.
- 1.10. **Treg me shumicë i energjisë** - nënkupton tregun brenda Shqipërisë në të cilin tregtohen produkte me shumicë të energjisë;
- 1.11. **Pjesëmarrës i tregut** - nënkupton çdo person fizik apo juridik, duke përfshirë operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, të cilët hyjnë në transaksione, duke përfshirë vendosjen e urdhrave për tregti, në një ose më shumë tregje të energjisë me shumicë;
- 1.12. **Person** - nënkupton çdo person fizik ose juridik;
- 1.13. **Enti Rregullator i Energjisë ose "ERE"** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Ligjin nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".
- 1.14. **Autoritet Publik** - çdo organ, autoritet ekzekutiv qeveritar, ministri, organ publik, departament, agjenci ose autoritete të tjera të ngjashme që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, ligjzbatuese, rregullative, administrative ose gjyqësore në territorin e Shqipërisë;
- 1.15. **Operator i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike** - është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
- 1.16. **Shoqëri mëmë** - një shoqëri, e cila në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të

këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, si dhe përcaktuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- 1.17. **Shoqëri e kontrolluar** - shoqëria tjetër e cila vlerësohet si e kontrolluar nga shoqëria mëmë, si dhe përcaktuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 1.18. **Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror** - është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.
- 1.19. **Shpërndarja e gazit natyror** - kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar, të cilët kryejnë funksionin e shpërndarjes dhe janë përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit;
- 1.20. **Shpërndarja e energjisë elektrike** - kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficientësinë e energjisë.
- 1.21 **Pozitë dominuese** - është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
- 1.22. **Infrastrukturë kritike** - është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve ose pjesë të saj cënimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në funksionet jetike dhe sociale, shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien ekonomike të njerëzve në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë Palë Kontraktuese.
- 1.23. **Informacion i ndjeshëm i lidhur me mbrojtjen e infrastrukturës kritike** - nënkupton faktet/informacione në lidhje me një infrastrukturë kritike, të cilat nëse zbulohen mund të përdoren për të planifikuar dhe vepruar me qëllim për të shkaktuar çrregullimin apo shkatërrimin e instalimeve në infrastrukturën kritike;

- 1.24. **Informata konfidenciale** – do të thotë të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e aktiviteteve të energjisë që nuk janë më në aktivitetin publik dhe që shpallja e tyre mund t'i vërë në rrezik interesat tregtarë të subjektit fizik apo juridik; dhe
- 1.25. **Palët Kontraktuese** – do të thotë Palët Kontraktuese sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

KREU II**NDALIMI I TREGTIMIT DHE DETYRIMI PËR PUBLIKIM TË TË DHËNAVE****Neni 3****Ndalimi i tregtimit nga personat e brendshëm**

1. Personat që kanë informacion të brendshëm në lidhje me një produkt të energjisë me shumicë, e kanë të ndaluar që të:
 - 1.1. përdorin këtë informacion për të përvetësuar ose disponuar, apo të përpiqen për të përvetësuar ose disponuar, për llogari të tyre ose për llogari të një pale të tretë, direkt ose indirekt, produktet e energjisë me shumicë të cilave iu referohet ky informacion;
 - 1.2. zbulojnë këtë informacion te çdo person tjetër përveç rasteve kur një zbulimi i tillë bëhet në rrjedhën normale të ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të tyre;
 - 1.3. rekomandojnë ose nxisin një person tjetër, në bazë të informacionit të brendshëm, që të blejë ose të siguroj produktet e energjisë me shumicë me të cilat ai informacion është i lidhur.
2. Ndalimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet për personat e mëposhtëm, që posedojnë informacion të brendshëm në lidhje me një produkt të energjisë me shumicë:
 - 2.1 anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të një shoqërie
 - 2.2. personat me zotërimi në kapitalin e një shoqërie;
 - 2.3. personat që kanë qasje në informata nëpërmjet ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të tyre;
 - 2.4. personat që kanë fituar informacion të tillë nëpërmjet veprimtarisë kriminale;
 - 2.5. personat që e dinë, ose duhet ta dinë, se është informacion i brendshëm.
3. Pikat 1.1 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij Neni nuk zbatohen për operatorët e sistemit të transmetimit kur blejnë energji elektrike ose gaz natyror për të siguruar funksionimin e sigurtë të sistemit.
4. Ky nen nuk zbatohet për:
 - 4.1 Transaksionet e kryera në përmbushjen e një detyrimi që ka ardhur për shkak të blerjes ose shitjes së produkteve të energjisë me shumicë kur ky detyrim vjen si pasojë e një marrëveshjeje të lidhur, ose një urdhri për tregtimin, i vendosur përpara se personi në fjalë të binte në dijeni të informacionit të brendshëm;
 - 4.2 transaksionet e lidhura nga prodhuesit e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, operatorët e depozitimit të gazit natyror ose operatorët e importit të GNL-së, qëllimi i vetëm i të cilëve është mbulimi i humbjes së menjëhershme fizike që rezulton nga ndërprerjet e paplanifikuara, ku mosndërmarrja e një veprimi të tillë do të ndikonte që pjesëmarrësi i tregut të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet kontraktuale

ekzistuese ose kur veprimi i tillë është ndërmarrë në marrëveshje me operatorin e sistemit të transmetimit në fjalë për të siguruar funksionimin e sigurt të sistemit. Në një situatë të tillë, informacioni përkatës në lidhje me transaksionet duhet të raportohet tek ERE. Ky detyrim i raportimit nuk çënon detyrimin e përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1;

- 4.3 pjesëmarrësit e tregut që veprojnë sipas rregullave emergjente kombëtare, ku autoritetet kombëtare kanë ndërhyrë për të siguruar furnizimin me energji elektrike ose gaz natyror dhe mekanizmat e tregut janë pezulluar në një Palë Kontraktuese ose pjesë të tyre. Në këtë rast, autoriteti kompetent për planifikimin emergjent duhet të sigurojë publikimin në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje.
5. Kur personi i cili posedon informacion të brendshëm në lidhje me një produkt të energjisë me shumicë është një person juridik, ndalimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu për personat fizikë që marrin pjesë në vendimin për të kryer transaksionin për llogari të personit juridik në fjalë.
6. Kur informacioni shpërndahet për qëllime gazetareske ose shprehje artistike, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në media të tjera, përveç nëse:
- 6.1 këta persona kanë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndonjë avantazh ose përfitim nga shpërndarja e informacionit në fjalë; ose
- 6.2 zbulimi ose shpërndarja bëhet me qëllim të çrregullimit të tregut në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë.

Neni 4

Detyrimi për të publikuar informacionin e brendshëm

1. Pjesëmarrësit e tregut duhet të publikojnë në mënyrë efektive dhe në kohë informacionin që ata posedojnë në lidhje me biznesin ose shoqëritë të cilat pjesëmarrësi në fjalë i tregut, shoqëria e tij mëmë ose shoqëria e kontrolluar, zotërojnë ose kontrollojnë ose për çështjet e tyre operacionale për të cilat pjesëmarrësi në treg ose shoqëria është përgjegjëse, qoftë tërësisht ose pjesërisht. Ky publikim do të përfshijë informacione të rëndësishme për kapacitetin dhe përdorimin e objekteve për prodhim, magazinim, konsum ose transmetim të energjisë elektrike ose të gazit natyror, ose në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve të GNL-se, duke përfshirë gatishmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve.
2. Një pjesëmarrës tregu, përjashtimisht mund të vonoje nën përgjegjësinë e vetë, bërjen publike të informacionit të brendshëm, në mënyrë që të mos paragjykojë interesat e tij të ligjshme, me kusht që një veprim i tillë të mos mashtrojë publikun dhe me kusht që pjesëmarrësi i tregut të jetë në gjendje të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni dhe të mos marrë vendime në lidhje me tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë bazuar në atë informacion. Në një

situatë të tillë, pjesëmarrësi i tregut, pa asnjë vonesë, do të vërë në dispozicion të ERE informacionin së bashku me arsyetimin për vonesën e publikimit të tij.

3. Kurdo që një pjesëmarrës tregu ose një person i punësuar ose që vepron në emër të një pjesëmarrësi të tregut, zbulon informacionin në lidhje me një produkt energjie me shumicë gjatë ushtrimit të zakonshëm të profesionit ose detyrave të tij, siç referohet në pikën 2 të Nenit 3 (1), pjesëmarrësi i tregut ose personi duhet të bëjë zbulimin e menjëhershëm, të plotë dhe efektiv të atij informacioni te publiku. Në rast të një zbulimi jo të qëllimshëm, pjesëmarrësi i tregut duhet të sigurojë publikimin e plotë dhe efektiv të informacionit sa më shpejt që të jetë e mundur pas zbulimit jo të qëllimshëm. Ky paragraf nuk do të zbatohet nëse personi që merr informacion ka detyrimin e fshehtësisë, pavarësisht nëse detyrimi i tillë rrjedh nga ligji, rregulloret, statuti i shoqërisë ose ndonjë kontratë.
4. Publikimi i informacionit të brendshëm, duke përfshirë formën e përmbledhur, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar ose udhëzimet dhe kodet e rrjetit të miratuara në përputhje me Rregulloren në fuqi, nënkupton publikim të menjëhershëm, të plotë dhe efektiv.
5. Paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë detyrimet e pjesëmarrësve të tregut sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, përfshirë udhëzimet dhe kodet e rrjetit të miratuara në përputhje me këto ligje dhe rregulla, veçanërisht në lidhje me kohën dhe mënyrën e publikimit të informacionit.
6. Paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë të drejtën e pjesëmarrësve të tregut për të vonuar zbulimin e informacionit të ndjeshëm në lidhje me mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre, nëse është e klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.
7. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pjesëmarrësit e tregut do të plotësojnë formularët respektivë të paraqitur në Shtojcën A. ERE do të publikoj në faqen e saj elektronike Shtojcën A e cila duhet të përcaktojë:
 - 7.1. mënyrën, efektivitetin dhe afatin kohor për publikimin e informacionit brenda subjektit të paragrafit (1) të këtij neni;
 - 7.2. rastet që justifikojnë publikimin e vonuar në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, si dhe afatin kohor për, në këtë rast, rregullat e publikimit të zbatueshme;
 - 7.3. kërkesat dhe afatin kohor të zbatueshëm për publikim të njëkohshëm, të plotë dhe efektiv, siç përcaktohet në paragrafin (3) të këtij neni;

Neni 5

Ndalimi i Manipulimit të Tregut

Ndalohet çdo angazhim ose përpjekje për t'u përfshirë në manipulimin e tregut të energjisë me shumicë.

KREU III

MONITORIMI DHE REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE NË TREG

Neni 6

Monitorimi i tregut

1. ERE do të monitorojë aktivitetin tregtar të produkteve të energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në informacionin e brendshëm dhe manipulimin e tregut vendor.
2. ERE do të bashkëpunojë në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë në kryerjen e monitorimit të tregjeve të energjisë me shumicë të referuara në pikën 1 të këtij Neni.
3. Për monitorim të tregut të energjisë me shumicë, ERE duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës, apo ndonjë organ tjetër për monitorimin e tregut. Në kryerjen e monitorimit të tregut, Autoriteti i Konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ERE në zbatim të pjesës së parë të këtij paragrafi, fjalia e dytë e nenit 4 paragrafi 2 dhe nenit 13. ERE, jo më vonë se data 30 qershor i çdo viti, duhet t'i dërgoj Sekretariatit një raport për aktivitetet e vitit paraprak sipas kësaj Rregulloreje, dhe gjithashtu ky raport duhet të publikohet në faqen elektronike të ERE-së.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, ERE do të bashkëpunojë ose do të hyjë në marrëveshje me autoritetet përkatëse kombëtare për kryerjen dhe përcaktimin e procedurave për ekzekutimin e përgjegjësive që i nënshtrohen këtij neni. Në rast të marrëveshjeve të tilla ato do të publikohen në faqen zyrtare të ERE-së.

Neni 7

Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut

1. Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte të energjisë me shumicë në Shqipëri, ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit, duhet të regjistrohen pranë ERE-së. Për qëllime të regjistrimit, me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, ERE do të aplikoj formatin e regjistrimit të hartuar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë dhe do ta publikoj në faqen zyrtare elektronike.
2. Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut bëhet pa çenuar detyrimet për të qenë në përputhje me rregullat e zbatueshme të tregtimit dhe balancimit.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, ERE do të krijojë regjistra të pjesëmarrësve të tregut në nivel kombëtar, të cilët do t'i mbaj të përditësuar. Regjistri duhet t'i japë secilit pjesëmarrës të tregut një numër identifikues unik dhe duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për të identifikuar pjesëmarrësin e tregut, duke përfshirë detajet përkatëse në lidhje me numrin e TVSH-së (tatimit mbi vlerën e shtuar), vendin e themelimit, personat përgjegjës për vendimet

operacionale dhe tregtare dhe kontrolluesin ose përfituesin fundor të aktiviteteve tregtare të pjesëmarrësit të tregut. Regjistri i pjesëmarrësve të tregut do jetë publik.

4. ERE do t'ia prezantojë Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë informatat nga regjistri i vetë kombëtar.
5. Pjesëmarrësit e tregut të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të dorëzojnë formularin e regjistrimit në ERE përpara se të hyjnë në një transaksion me produktet e energjisë me shumicë.
6. Pjesëmarrësit e tregut të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të komunikojnë menjëherë në ERE çdo ndryshim që ka ndodhur në lidhje me informatat e dhëna në formularin e regjistrimit.

KREU IV INFORMATAT KONFIDENCIALE

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave

Kjo Rregullore nuk do të çënoj detyrimet e ERE-së për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Neni 9

Besueshmëria Operacionale

1. ERE duhet të sigurojë konfidencialitetin, integritetin dhe mbrojtjen e informacionit të marrë në përputhje me nenin 4 dhe nenin 6 të kësaj Rregulloreje. ERE duhet të marri të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo keqpërdorim dhe qasje të paautorizuar në informacionin e mbajtur në sistemin e saj. ERE, Autoriteti i Konkurrencës dhe autoritetet e tjera përkatëse duhet të sigurojnë konfidencialitetin, integritetin dhe mbrojtjen e informacionit që ata marrin në përputhje me nenin 4 dhe nenin 6 të kësaj Rregulloreje, dhe duhet të ndërmarrin hapa për të parandaluar keqpërdorimin e një informacioni të tillë.
2. ERE mund të vendosë të publikojë pjesë të informacionit që posedon, me kusht që informacioni i ndjeshëm tregtar për pjesëmarrësit individual të tregut, ose transaksionet individuale ose vendet e veçanta të tregut të mos zbulohen dhe mos të nxirren përfundime.
3. ERE duhet të vërë në dispozicion bazën e të dhënave tregtare komercialisht jo të ndjeshme për qëllime shkencore, në përputhje me kërkesat e konfidencialitetit.

Neni 10

Detyrimet e personave që profesionalisht rregullojnë transaksionet

1. Çdo person që profesionalisht rregullon transaksionet për produktet e energjisë me shumicë i cili në mënyrë të arsyeshme dyshon se transaksioni mund të shkelë Nenin 3 dhe Nenin 5, do të njoftojë ERE-në pa vonesa të mëtejshme.
2. Personat që rregullojnë profesionalisht transaksionet në produktet e energjisë me shumicë, duhet të krijojnë dhe mbajnë rregulla dhe procedura efektive për të identifikuar shkeljet e parashikuara në Nenin 3 dhe Nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Bashkëpunimi në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe në nivel kombëtar

1. ERE do të bashkëpunojë me rregullatorët e energjisë të palëve kontraktuese në kuadër të komunitetit të energjisë, duke përfshirë bashkëpunimin në nivel rajonal nëpërmjet Bordit

Rregullator të Komunitetit të Energjisë për qëllimet e kryerjes së detyrave të tyre në përputhje me këtë Rregullore.

2. ERE, Autoriteti i Konkurrencës dhe autoritetet tjera kompetente, mund të krijojnë forma të përshtatshme bashkëpunimi në mënyrë që të sigurojnë hetim dhe zbatim efektiv dhe eficientë dhe të kontribuojnë në një qasje koherente dhe të qëndrueshme ndaj hetimit, procedurave gjyqësore dhe zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe ligjeve përkatëse financiare dhe të konkurrencës.
3. ERE pa vonesë do të informojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në mënyrë sa më specifike, kur ka bazë të arsyeshme për të dyshuar se veprimet në shkelje të kësaj Rregullore janë duke u kryer ose janë kryer brenda vendit ose nga një Palë tjetër Kontraktuese.
4. Kur ERE dyshon se veprimet që kryhen në një Palë Kontraktuese tjetër janë duke ndikuar në tregjet ose çmimet e produkteve të energjisë me shumicë në Shqipëri, atëherë mund të kërkojë nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë të sigurojnë që kërkesat e rregullores REMIT të zbatohen në atë Palë Kontraktuese.
5. Për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj abuzimit të tregut të energjisë me shumicë, ERE do të informojë Autoritetin e Konkurrencës, Sekretariatit dhe Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, kur ka bazë të arsyeshme për të dyshuar se ka veprime që janë duke u kryer ose janë kryer në tregun e energjisë me shumicë, të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në vend apo tek Palët Kontraktuese.
6. Në kuadër të bashkëpunimit me ECRB, ERE :
 - 6.1 Do t'i sigurojë Bordit të Rregullatorit të Komunitetit të Energjisë çdo informacion në lidhje me shkeljet e dyshuara, nëse kërkohet;
 - 6.2 do të fillojë hetim për shkeljen e dyshuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të korrigjuar çdo shkelje të gjetur;
 - 6.3 do të koordinojë hetimet rreth shkeljes së mundshme që ka pasur efekt ndërkufitar në përputhje me procedurat e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë.
7. Nëse ERE merr një kërkesë për informacion referuar paragrafit 6 të këtij neni ose merr një kërkesë për fillimin e hetimit të një shkeljeje të dyshuar, menjëherë duhet të marrë masat e nevojshme për të adresuar atë kërkesë. Nëse ERE nuk është në gjendje që menjëherë të japë informacionin e kërkuar, atëherë do të njoftojë pa vonesë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për arsyet e vonesës.

ERE mund të refuzojë të veprojë në një kërkesë për informacion, kur:

- 7.1 pranueshmëria mund të ndikojë negativisht në sovranitetin ose sigurinë e vendit;
- 7.2 procedurat gjyqësore tashmë kanë filluar në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër personave të njëjtë, tek autoritetet përgjegjëse; ose

7.3 një gjykim final është marr në lidhje me këta persona, për të njëjtat veprime në vend.

Në një rast të tillë, ERE njofton Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë në përputhje me rrethanat, duke dhënë informacion sa më të detajuar për ato procedura ose gjykimin.

8. ERE do të marrë pjesë në një grup hetimor të koordinuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë i thirrur në përputhje me paragrafin 6, duke dhënë të gjithë ndihmën e nevojshme.

Neni 12

Sekreti profesional

1. Çdo informacion konfidencial i pranuar, i shkëmbyer ose i transmetuar në pajtim me këtë Rregullore i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuar në këtë nen.
2. Detyrimi i fshehtësisë profesionale zbatohet për:
 - 2.1. personat që punojnë ose kanë punuar për ERE-në ose në ndonje autoritetet tjetër, që është ose mund të jetë në posedim, ose që merr një informacion të tillë në përputhje me këtë rregullore ose ndonjë proces hetimor;
 - 2.2. auditorët dhe ekspertët e informuar nga ERE dhe autoritetet e tjera kompetente.
3. Informatat konfidenciale të marra nga personat e përmendur në pikën 2 të këtij Neni, gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk mund të zbulohen te ndonjë person apo autoritet tjetër, përveç se në formë të përmbledhur në mënyrë që një pjesëmarrës tregu individual ose vendi i tregut nuk mund të identifikohet, përjashtuar rasteve të parashikuara në legjislacionin penal, dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje ose legjislacionit tjetër relevant të Shqipërisë dhe Komunitetit të Energjisë.
4. Pa paragjykuar rastet e parashikuara nga legjislacioni penal, ERE, organet ose personat të cilët marrin informacion konfidencial në mbështetje me këtë Rregullore, mund ta përdorin atë vetëm në kryerjen e detyrave të tyre dhe për ushtrimin e funksioneve të tyre. Autoritetet, organet ose personat e tjerë mund ta përdorin atë informacion për qëllimin për të cilin u është ofruar atyre ose në kontekstin e procedurave administrative ose gjyqësore që lidhen posaçërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve.
5. Ky Nen, nuk do të pengojë ERE-në që të shkëmbejë ose të transmetojë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, informacionin konfidencial me kusht që ai të mos jetë marrë nga një autoritet i një Pale tjetër Kontraktuese ose nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë apo Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë sipas kësaj Rregulloreje.

KREU V**MBIKQYRJA, HETIMI DHE MASAT ADMINISTRATIVE****Neni 13****Zbatimi i ndalimeve ndaj abuzimit të tregut**

1. ERE do të sigurojë që të zbatohen ndalimet e përcaktuara në Nenet 3, 5 dhe detyrimi i përcaktuar në Nenin 4.
2. ERE, në përputhje me kompetencat e dhëna nga Ligji për Sektorin e Energjisë si dhe ai për Gazin Natyror, do të ndërmarrë masa hetimi në lidhje me ndalimet dhe kërkesat sipas kësaj Rregulloreje, të cilat do të ushtrohen:

2.1 në mënyrë direkte;

2.2 në bashkëpunim me autoritetin e konkurrencës dhe autoritetet e tjera relevante; ose

2.3 me kërkesë të organeve gjyqësore dhe të prokurorisë.

Kur është e përshtatshme, ERE mund të ushtrojë kompetencat e veta hetimore në bashkëpunim me tregjet e organizuara, sistemet e përputhjes së tregtimit (trade-matching system) ose persona të tjerë që rregullojnë për shkak të profesionit transaksionet.

3. Veprimet hetuese dhe zbatuese të përcaktuara në paragrafin 1, do të përfshijnë të drejtën:
 - 3.1 për të patur akses në çdo dokument që gjykohet i rëndësishëm, në çdo formë si dhe të marrë një kopje të tij;
 - 3.2 të kërkojë informacion nga çdo person përkatës, përfshirë ata të cilët në mënyrë të njëpasnjëshme kanë bërë pjesë në komunikimin e urdhrave ose kryerjen e veprimeve në fjalë, përfshirë këtu edhe eprorët e tyre dhe, nëse është e nevojshme pasja e së drejtës për të thirrur dhe dëgjuar ndonjërin prej këtyre personave apo eprorëve të tyre;
 - 3.3 për të kryer inspektime në vendndodhje;
 - 3.4 për të kërkuar regjistrimet ekzistuese telefonike dhe të komunikimeve elektronike;
 - 3.5 për të kërkuar ndërprerjen e çdo praktike që është në kundërshtim me këtë Rregullore ose aktet e deleguara apo të miratuara të dala në zbatim të saj;
 - 3.6 për të kërkuar nga gjykata ngrirjen ose sekuestrimin e aseteve deri në përfundimin e hetimit;
 - 3.7 për të kërkuar nga gjykata ose ndonjë autoritet kompetent të vendosë ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë.

Neni 14**Afatet për marrjen e vendimit dhe publikimi i tij**

1. Vendimmarrja për fillimin e një procedure për vendosje gjobe si dhe vendimmarrja për konstatimin dhe vendosjen e gjobës, përfshirë dhe afatet e parashikuara për këto dy vendimmarrje,

ERE i merr bazuar në nenin 107 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 106 të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10 279, datë 20.05.2010, “Për Kundërvajtjet Administrative”, Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 125, datë 29.07.2016 dhe Rregulloren mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 04.07.2017.

2. ERE në raste të veçanta si dhe parashikuar në nenet 91 dhe 92 të Kodit të Procedurave Administrative mund ta zgjasë afatin për marrjen e vendimit me 30 ditë.
3. Të gjitha vendimet merren në mënyrë të pavarur nga cilido organ publik, apo çfarëdo shoqëri publike apo private.
4. ERE boton në Fletoren Zyrtare si dhe publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e marra.
5. Të dhënat të cilat konsiderohen sekret tregtar do të përjashtohen nga publikimi sipas paragrafit 4 të këtij Neni.

Neni 15

E drejta e ankesës

1. Kundër vendimit të ERE-së, me të cilin konstatohet shkelja e kësaj Rregulloreje dhe aplikimit të masave ndëshkuese si dhe kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, pjesëmarrësi i tregut mund të kërkojë rishikimin e këtij vendimi në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Kundër vendimit për aplikimin e gjobës, brenda afateve të parashikuara ligjore përkatësisht në nenin 16, pika 6 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenin 17, pika 3 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nga publikimi i vendimit, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative në Republikën e Shqipërisë.
3. Fillimi i procesit gjyqësor administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 16

Masat administrative dhe Gjobat

1. ERE do të ndërmarrë masat e mëposhtme administrative për shkeljen e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1 Të detyrojë personin fizik ose juridik që të ndërpresë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkelje sipas kësaj Rregulloreje;
 - 1.2 Të shpallë të pavlefshëm çdo akt ose vendim që përbën shkelje, të anullojë ose të shfuqizojë atë;
 - 1.3 Të detyrojë personat fizikë dhe juridikë që të kryejnë të gjitha veprimet e arsyeshme që konsiderohen si të nevojshme për të eliminuar efektet negative, dhe zbatimin e masave;

-
- 1.4 Të përcaktojë masa të përkohshme në lidhje me shkeljen e supozuar.
2. Pavarësisht masave administrative të përcaktuara në këtë Rregullore, ERE mund të vendosë edhe gjoba për personat fizikë dhe juridik në pajtim me nenin 107 të ligjit nr.43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike ashtu dhe nenin 106 të ligjit nr.102/2015 për Sektorin e Gazit Natyror, si në vijim:
- 2.1 Nuk jep informata të kërkuara sipas kësaj Rregulloreje;
 - 2.2 Zbulon informata konfidenciale në mënyrë të papranueshme;
 - 2.3 Nuk jep ndihmën e kërkuar dhe nuk pranon të bashkëpunojë me organet kompetente;
 - 2.4 Nuk vepron në pajtim me masat e vendosura për të parandaluar keqpërdorimin e pozitës dominuese;
 - 2.5 Mban llogari që nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - 2.6 Vepron në kundërshtim me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.
3. Për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ndaj personit fizik dhe juridik do të aplikohen gjoba nga (500 000 Lekë) den në kufirin ligjor të përcaktuar në ligjet e përmendura në pikën 3 të këtij neni.
4. Niveli i gjobës sipas paragrafit 3 të këtij Neni, do të varet nga faktorët si në vijim:
- 4.1 Vlera materiale e dëmit të shkaktuar;
 - 4.2 Numri i konsumatorëve të prekur;
 - 4.3 Përfitimet financiare nga veprimet e paligjshme të ndërmarra; dhe
 - 4.4 Ndikimi i shkeljes në funksionin e tregut të energjisë.
5. ERE në përputhje me nenin 107, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenin 106, pika 1, germa “ç” të ligjit nr.102/2015 për Sektorin e Gazit Natyror, nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 125, datë 29.07.2016 dhe neneve 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 04.07.2017 mund të aplikojë gjobë progresive ose ta reduktoj atë rast pas rasti.
6. ERE pas pranimit të përgjigjeve me shkrim nga personat fizikë dhe juridikë do t’i vlerësojë ato dhe do të nxjerr vendimin në përputhje me konstatimet dhe shkeljet e vërtetuara.
7. Gjoba e vendosur nga bordi i ERE përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.
8. Masat administrative dhe gjobat e vendosura nga ana e ERE-së, nuk përjashtojnë përgjegjësinë civile dhe përgjegjësinë penale sipas legjislacionit në fuqi.

9. ERE do t'i bëjë publike masat ose gjobat e vendosura sipas paragrafit 1 për shkelje të kësaj Rregulloreje, përveç rastit nëse një zbulimi i tillë do të shkaktonte dëme joproportionale për palët e përfshira.

10. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Ndryshimet

1. ERE ka të drejtën që të ndryshojë ose të modifikoj çdo dispozitë të kësaj Rregulloreje.
2. Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulloreje do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 18

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-së, do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të ERE-s.

SHTOJCA (A)

Format që do të plotësohen sipas Rregullores REMIT.

Forma 1

Kjo formë do të përdoret për paraqitjen e informacionit nga ERE në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në rast të dyshimeve për ndikime abuzive në Palët Kontraktuese bazuar në nenin 4(1) të ECRB, akti procedural 01/2020.

A. Informacion i Përgjithshëm

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Pala Kontraktuese	
2	Rregullatori Raportues	
3	Personi i cili përfaqëson rregullatorin në lidhje me këtë raportim, detaje të kontaktit (e-mail, telefon)	
4	Data e paraqitjes në seksionin e ECRB:	
5	Adresa e e-mailit e seksionit ECRB për paraqitjen e raportit	[të jepet nga seksioni i ECRB-së]
6	Informacione të tjera (nëse është e nevojshme)	

B. Informacion mbi shkeljen e dyshuar

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Produkti: -Energji elektrike ose gaz në tregun me shumicë	

2	Pala kontraktuese ku dyshohet se ka ndodhur ndikimi abuziv	
3	Kategoria e dyshuar e shkeljes së rregullores REMIT: -Tregtim; -Manipulim i tregut.	
4	Jepni një përmbledhje të shkeljes së dyshuar (përmbledhje e detajuar jepet në pikën C më poshtë)	
5	Data (dhe ora nëse është e aplikueshme) kur ka ndodhur shkelja e dyshuar ose kur ka filluar	
6	Si mësoi rregullatori për këtë shkelje	
7	Pjesëtari i tregut i përfshirë në këtë shkelje të dyshuar	
8	A është kryer, apo po kryhet ndonjë monitorim/hetim administrativ nga rregullatori raportues (në rast se shkelja ka ndodhur në vendin në juridiksionin e rregullatorit raportues)	
9	Cila është pikëpamja e rregullatorit raportues mbi ndikimin e përgjithshëm në treg	
10	Cila Palë Kontraktuese mund të ndikohet nga shkelja e dyshuar (ose është ndikuar)	
11	Cili është rekomandimi i rregullatorit raportues për ECRB, në lidhje me shkeljen e dyshuar	
12	A përfshin ky raport ose ndonjë nga shtojcat ndonjë informacion konfidencial (nëse po, ju lutem evidentoni se cilat janë informacionet konfidenciale ose komerciale sensitive)	

	Jepni të dhëna pse ky informacion është konfidencial ose komercial sensitiv.	
13	Jepni listën e shtojcave që i janë bashkëlidhur këtij raporti.	

C. Siguroeni një informacion më të detajuar mbi shkeljen e supozuar

[...]

[Nëse është e nevojshme përfshini shtojca, tabela Excel, etj. Për të dokumentuar rastin.]

Forma 2

Raportimi i shkeljeve potenciale të rregullores REMIT në ERE dhe/ose ECRB bazuar në nenin 7 të aktit procedural 01/2020.

Çdo person fizik ose juridik duke përdorur këtë formë mund të raportojë për sjellje të dyshimta në tregun me shumicë të energjisë elektrike dhe te gazit natyror dhe për çdo shkelje të rregullores REMIT në ERE dhe/ose ECRB.

A. Informacion i Përgjithshëm

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Pala Raportuese: - pjesëtar tregu; - autoritet tjetër kompetent; - tjetër.	[Emri i personit/firma/pozicioni që ka dhe adresa]
2	Personi i cili përfaqëson palën raportuese në lidhje me këtë raportim, detaje të kontaktit (e-mail, telefon)	

3	Adresa e-mail e ERE për dërgimin e raportit	[do të publikohet nga ECRB, si dhe nga ERE në faqen zyrtare web]
4	Adresa e e-mail e njësisë së ECRB për dërgimin e raportit	[do të sigurohet nga ECRB nëse pala raportuese do ta dërgoj raportin në ECRB]
5	Data e paraqitjes	
6	Informacione të tjera (nëse është e nevojshme)	

B. Informacion mbi shkeljen e dyshuar

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Produkti: -Energji elektrike ose gaz në tregun me shumicë	
2	Pala kontraktuese ku dyshohet se ka ndodhur shkelja e dyshuar	
3	Kategoria e shkeljes se dyshuar të REMIT: - Tregtim; - Nxjerrje e informacioneve të brendshme; - Manipulim i tregut; - Detyrim për regjistrim; - Tjetër.	
4	Jepni një përmbledhje të shkeljes së dyshuar (përmbledhje e detajuar jepet në pikën C më poshtë)	
5	Data (dhe ora nëse është e aplikueshme) kur ka ndodhur shkelja e dyshuar ose kur ka filluar	

6	Si mori dijëni pala raportuese për këtë shkelje të supozuar	
7	Pjesëtari i tregut i përfshirë në këtë shkelje të dyshuar	
8	A jeni në dijëni të ndonjë monitorimi/hetimi administrative nga ERE në lidhje me këtë shkelje	
9	Cila është pikëpamja e palës raportuese mbi ndikimin e përgjithshëm në treg (informacion i detajuar jepën në pikën C më poshtë)	
10	Cila Palë Kontraktuese tjetër mund të ndikohet nga shkelja e dyshuar (ose është ndikuar)	
11	A përfshin ky raport ose ndonjë nga shtojcat, ndonjë informacion konfidencial (nëse po, ju lutem evidentoni se cilat janë informacionet konfidenciale ose komerciale sensitive) Jepni të dhëna pse ky informacion është konfidencial ose komercial sensitiv.	
12	Jepni listën e shtojcave që i janë bashkëlidhur këtij raporti.	

C. **Siguroeni një informacion më të detajuar mbi shkeljen e supozuar**

[...]

[Nëse është e nevojshme përfshini shtojca, tabela Excel, etj. Për të dokumentuar rastin.]

Forma 3

Raportimi në ERE lidhur me publikimin e vonuar të informacionit të brendshëm bazuar në nenin 8 të aktit procedural 01/2020, të ECRB.

Bazuar në Rregulloren REMIT një pjesëtar tregu mundet që nën përgjegjësinë e tij të vonojë bërjen publike të informacioneve të brendshme pa paragjykuar interesin e tij legjitim, publikimi i këtij informacioni nuk duhet të keqorientojë publikun, si dhe të sigurojë që pjesëtari i tregut është në

gjendje të sigurojë konfidencialitetin e këtij informacioni, si dhe të mos marrë vendime që lidhen me tregtimin e shumicës së produkteve të energjisë bazuar në këtë informacion. Në situata të tilla, pjesëtari i tregut pa vonesë duhet të paraqesë një informacion me justifikimin për vonesën e bërjes publike të informacionit në ERE.

Kjo Formë do të përdoret nga pjesëtari i tregut për të paraqitur këtë informacion në ERE.

A. Informacion i përgjithshëm

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Emri dhe adresa e pjesëtarit të tregut raportues	
2	Personi i cili përfaqëson palën raportuese në lidhje me këtë raportim, detaje të kontaktit (e-mail, telefon)	
3	Tipi i pjesëtarit të tregut: - Prodhues i energjisë elektrike ose gazit; - Operator i infrastrukturës së energjisë elektrike ose gazit; - Tjetër (jepni një përshkrim)	
4	Adresa e e-mail e ERE për të paraqitur raportin	[Do të sigurohet nga ERE]
5	Data e paraqitjes	
6	Informacione të tjera (nëse është e nevojshme)	

B. Informacioni lidhur me informacionin e brendshëm sipas kësaj forme

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Emri i subjektit	
2	Fuqia e instaluar e këtij subjekti	
3	Kapaciteti i padisponueshëm	

4	Data, përfshirë orët e ndërprerjes së paplanifikuar (nga ne)	
5	Koha e pritshme për t'u bërë publike	
6	Adresa/linku ku do të bëhet publik informacioni	
7	Detaje të tjera	

C. Justifikimi mbi vonesën e publikimit

[...]

Informacion shtesë, mund të kërkohet nga ERE.

Forma 4

Regjistrimi në ERE.

Kjo Formë do të përdoret me qëllim regjistrimin e pjesëtarëve të tregut dhe nuk ka qëllime publikimi, bazuar në nenin 9(2) të aktit procedural 01/2020 të ECRB.

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Autoriteti regjistruar	
2	Shteti	
3	Forma e Përdoruesit	Të plotësohet nga pjesëmarrësi i tregut
4	Data e paraqitjes	
5	Të dhëna për regjistrimin e kompanisë	
6	Emri ligjor i kompanisë	
7	Forma ligjore	
8	Adresa e kompanisë (Zyrat Qendrore)	
9	Qyteti ku ndodhet kompania	
10	ZIP Code	
11	Shteti	

12	Kodi EIC i kompanisë	
13	Kodi BIC i kompanisë	
14	Kodi LEI i kompanisë	
15	NIPT i kompanisë	
16	Website	
17	A jeni punonjës i kompanisë	
18	Të dhëna mbi pronësinë e kompanisë	
19	Emri i drejtorit	
20	Mbiemri i drejtorit	
21	E-mail i drejtorit	
22	Kontrollori final	
23	Hapja e informacionit të brendshëm	
24	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 1	
25	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 2 (nëse ka)	
26	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 3 (nëse ka)	
27	Personi i kontaktit për çështjet e regjistrimit	
28	Emri i personit të kontaktit për çështjet e regjistrimit	
29	Mbiemri i personit të kontaktit për çështjet e regjistrimit	
30	E-mail i personit të kontaktit për çështjet e regjistrimit	
31	Telefoni i personit të kontaktit për çështjet e regjistrimit	

32	Personi i kontaktit për çështjet ligjore	
33	Emri i personit të kontaktit për çështjet ligjore	
34	Mbiemri i personit të kontaktit për çështjet ligjore	
35	E-mail i personit të kontaktit për çështjet ligjore	
36	Telefoni i personit të kontaktit për çështjet ligjore	
37	Personi i kontaktit për çështjet komerciale	
38	Emri i personit të kontaktit për çështjet komerciale	
39	Mbiemri i personit të kontaktit për çështjet komerciale	
40	E-mail i personit të kontaktit për çështjet komerciale	
41	Telefoni i personit të kontaktit për çështjet komerciale	
42	Personi i kontaktit për çështje të tjera	
43	Emri i personit të kontaktit për çështje të tjera	
44	Mbiemri i personit të kontaktit për çështje të tjera	
45	E-mail i personit të kontaktit për çështje të tjera	
46	Telefoni i personit të kontaktit për çështje të tjera	

Forma 5

Kjo Formë përdoret me qëllim krijimin e një regjistri kombëtar të pjesëmarrësve të tregut, i cili publikohet.

Nr.	Emërtimi	Informacioni që do të sigurohet
1	Autoriteti regjistrues	
2	Shteti	
3	Forma e Përdoruesit	Të plotësohet nga pjesëmarrësi i tregut
4	Data e paraqitjes	
5	Të dhëna për regjistrimin e kompanisë	
6	Emri ligjor i kompanisë	
7	Forma ligjore	
8	Adresa e kompanisë (zyrat qendrore)	
9	Qyteti ku ndodhet kompania	
10	ZIP Code	
11	Shteti	
12	Kodi EIC i kompanisë	
13	Kodi BIC i kompanisë	
14	Kodi LEI i kompanisë	
15	NIPT i kompanisë	
16	Website	
17	A jeni Punonjës i kompanisë	
18	Hapja e Informacionit të brendshëm	

19	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 1	
20	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 2 (nëse ka)	
21	Webpage ku janë publikuar informacionet e brendshme: 3 (nëse ka)	